



An Roinn Oideachais  
agus Scileanna  
Department of  
Education and Skills

# Vazhdimi i Shkollimit

Udhëzime për prindërit/  
kujdestarët e nxënësve të  
shkollës fillore

13 Maj 2020

Të nderuar Prindër / Kujdestarë,

Po ju shkruajmë për t'ju mbështetur dhe për t'ju dhënë informacione që mund të jenë të dobishme gjatë kësaj periudhe të mbylljes së shkollës. Pa dyshim, kjo është një kohë e pazakontë dhe shqetësuese për shumë prindër dhe fëmijët e tyre, pasi ata po i përshtaten mënyrave të reja të punës dhe jetesës gjatë krizës aktuale. Për shkollat dhe mësuesit, është gjithashtu një kohë sfiduese, pasi ata përpiqen t'i mbajnë gjërat në një farë mënyre normale për nxënësit e tyre, ndërsa mbështesin mësimin e tyre në mënyra që janë krejt të ndryshme nga përvoja normale e klasës. Me mbështetjen e prindërve, shkollat dhe mësuesit po luajnë një rol kryesor për t'i ndihmuar nxënësit të qëndrojnë të lidhur me të tjerët, të vazhdojnë interesin e tyre për punën e tyre shkollore dhe të përparojnë mësimin e tyre.

Ky udhëzim ka për qëllim t'ju mbështesë ndërsa fëmija juaj është në shtëpi. Ai përshkruan se si shkolla dhe mësuesit do ta ndihmojnë fëmijën tuaj në këtë kohë dhe do t'ju japin disa këshilla praktike se si mund të mbështetni mësimin e fëmijës suaj dhe ta mbani fëmijën tuaj të sigurt. Gjithashtu ju këshillon për përkrahjet që janë në dispozicion nga shkolla dhe gjetkë për ju si prind ose kujdestar në këtë kohë. Nëse fëmija juaj po ndjek një shkollë speciale, këshillat në këtë udhëzim do të jenë të dobishme për ju.

### **Çfarë mund të pres nga shkolla e fëmijës tim?**

Tani shkollat do t'i kenë njohtuar prindërit për qasjen e tyre për të komunikuar dhe për të mbështetur mësimin e nxënësve të tyre nga shtëpia. Mund të prisni që shkolla dhe mësuesit do t'ju mbështesin juve dhe fëmijën tuaj duke:

#### **Inkurajimi**

*duke ndihmuar fëmijën tuaj të qëndrojë i motivuar dhe të përparojë në mësimin e tyre në këtë kohë sfiduese*

#### **Duke mbajtur kontakt**

*duke ju treguar se si do të mbajnë kontakte me ju dhe fëmijën tuaj gjatë kësaj kohe dhe gjithashtu si mund të kontaktoni shkollën, nëse dhe kur duhet*

#### **Caktimi i punës**

*caktimi i punës dhe aktiviteteve për fëmijën tuaj në përputhje me aftësinë, përparimin dhe nivelin e klasës*

#### **Përgjigja**

*duke ofruar reagime të dobishme dhe në kohë për punën që fëmija juaj ka përfunduar dhe kthyer tek mësuesi*

#### **Konsultimi**

*duke kërkuar feedback nga ju për të siguruar që sasia e punës që ata kanë dhënë është e menaxhueshme, por mjaft sfiduese për fëmijën tuaj*

#### **Kontrollimi qasje**

*duke punuar me ju për të gjetur mënyra për të mbështetur mësimin e fëmijës tuaj ku mbulimi me internet është i dobët ose nuk keni qasje në pajisjet digjitale*

## Sa shpesh duhet të pres që të dëgjoj nga mësuesi/shkolla e fëmijës tim?

Ministria e Arsimit dhe Aftësive ka këshilluar shkollat fillore që kur është e mundur, mësuesit e klasës duhet të angazhohen me nxënësit e tyre në baza ditore ose të paktën disa herë në javë.

Nëse fëmija juaj ka nevoja të posaçme për shkollim, mund të prisni kontakte të rregullta dhe në disa raste të përditshme, nga mësuesi i arsimit special dhe/ose mësuesi i klasës. Kur fëmija juaj ka marrë mbështetje nga një mësues vizitues për shurdhim/vështirësi në dëgjim ose për të verbër/ vështirësi në të pamurit, mund të prisni kontakt të rregullt nga ai mësues vizitor.

Ndihma nga shkolla për mësimin e fëmijës tuaj në shtëpi do të jetë e ndryshme nga ajo e parashikuar gjatë një dite normale në shkollë. Sa shpesh shkolla dhe mësuesit merren me ju dhe fëmijën tuaj, dhe si e bëjnë këtë, qoftë me mesazhe, thirrje video apo ndërveprime të platformës që përfshijnë caktimin e punës ose mësimin e drejtpërdrejtë, do të varet nga disa gjëra.

Në veçanti, angazhimi do të varet nga lloji i komunikimit që është i mundur për ju, shkollën dhe mësuesit dhe nga qasja që mbështet më së miri mësimin e fëmijës tuaj gjatë kohës që është në shtëpi. Një komunikim i tillë do të ndryshojë në përputhje me teknologjinë dhe burimet e internetit, të disponueshëm në shkollë dhe në shtëpi dhe me mundësitë që shkolla ka për të ndarë me nxënës materiale mësimore në kopje. Ai gjithashtu do të ndryshojë në përputhje me programin e punës që mësuesi ka planifikuar për klasën e tyre, duke marrë parasysh nevojat mësimore të nxënësve, burimet e disponueshme dhe kërkesat e veçanta të mësimin në distancë.

## Si do të komunikojë shkolla me mua dhe/ose fëmijën tim?

Mund të prisni që komunikimi midis mësuesve dhe juve ose fëmijës tuaj do të jetë përgjithësisht në lidhje me të mësuarit e tyre dhe do t'ju ndihmojë për ta mbështetur atë. Mund të ndryshojë midis punës që mësuesi do t'i kërkojë fëmijës tuaj të bëjë në mënyrë të pavarur dhe mësim të drejtpërdrejtë nga mësuesi. Shkolla gjithashtu do të mbështesë fëmijën tuaj për ta mbajtur të motivuar, aktiv dhe të ndjehet mirë. Aktivitetet e tyre mësimore mund të përfshijnë një ekuilibër të:

- detyra të caktuara siç janë aktivitetet e shkruara, praktike dhe puna me projekt dhe
- kur janë në dispozicion lehtësira të përshtatshme, mësimi online, siç janë orët virtuale, videot e mësimëve, prezantimet ose përdorimi i burimeve të mësimin në internet të rekomanduara nga mësuesi.

Ju dhe fëmija juaj duhet të merrni aktivitete mësimore nga shkolla dhe mësuesit në një ose më shumë mënyra, si p.sh. me postë, postë elektronike, aplikacione komunikimi ose në faqen e internetit të shkollës. Kur teknologjia lejon, fëmija juaj mund të ketë një angazhim të rregullt me mësuesin e tyre në platforma të tilla si Google Classroom, Microsoft Office 365 dhe Edmodo ose të marrë pjesë në takime live përmes përdorimit të mjeteve të tilla si Google Meet, Microsoft Teams dhe Eëbex.

Shkollave u është kërkuar të jenë të vetëdijshëm për nxënësit që mund të mos kenë qasje në internet dhe të përshtatin qasjet në mënyrë që këta nxënës të vazhdojnë të kenë mundësinë për të marrë pjesë në mësim. Nëse keni vështirësi me qasjen në internet ose me pajisje dhe printerë, duhet të njoftoni shkollën ose mësuesin e klasës, në mënyrë që ata të shohin se cilat marrëveshje alternative mund të vendosen për fëmijën tuaj.

Mund t'ju marrin në telefon nga shkolla ose mësuesi për të kontrolluar fëmijën tuaj, për t'ju mbështetur për të ndihmuar në mësimin e fëmijës tuaj dhe për të adresuar çdo shqetësim. Një kontakt i tillë i zakonshëm një-me-një do të jetë veçanërisht i dobishëm nëse fëmija juaj ka nevoja të veçanta arsimore ose e ka të vështirë t'i ndjekë detyrat e caktuara. Ky kontakt i rregullt me mësuesin gjithashtu do të jetë i dobishëm nëse e keni të vështirë të motivoni fëmijën tuaj ose të mbështesni mësimin e fëmijës tuaj në shtëpi. Nëse shkolla ka një koordinator të Komunitetit të Shkollimit në Shtëpi (HSCL), ju gjithashtu mund t'i kontaktoni ata për ndonjë shqetësim që mund të keni.

Informacione të mëtutjeshme nga Ministria se si shkollat dhe mësuesit mund të mbështesin mësimin e nxënësve, përfshihen në *Udhëzimin për Vazhdimësinë e Shkollimit për Shkollat Fillore dhe Pas Fillores*. Ky dhe dokumentet e tjera udhëzuese që kanë të bëjnë me mbështetjen për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe ata në rrezik të disavantazhit arsimor janë në dispozicion në faqen e [Covid-19](#) të faqes së internetit të Ministrisë.

### **Me kë mund të kontaktoj nëse kam ndonjë pyetje ose shqetësim për mësimin e fëmijës tim?**

Deri më tani, shkolla duhet t'ju ketë këshilluar se si të kontaktoni dhe me kë të kontaktoni, nëse ju ose fëmija juaj keni nevojë për këshilla ose nëse keni ndonjë pyetje ose shqetësim në lidhje me mësimin e fëmijës tuaj. Nëse nuk jeni të sigurt se me kë mund të kontaktoni, faqja e internetit e shkollës mund të sigurojë informacionin që ju kërkoni.

Mësuesi i klasës dhe/ose mësuesi i arsimit special do të jenë një pikë e rëndësishme kontakti dhe / ose mbështetje për ju. Drejtori ose zëvendësdrejtori i shkollës gjithashtu duhet të jetë në gjendje të ndihmojë nëse keni pyetje.

Nëse fëmija juaj po ndjek një shkollë DEIS, shkolla do të ketë gjithashtu një koordinator për Ndërlidhjen e Shkollës Shtëpiake (HSCL) dhe / ose një koordinator të një Programi të Përfundimit Shkollor (SCP). Koordinator i Ndërlidhjes së Komunitetit të Shkollave Shtëpiake (HSCL) është aty për të ofruar këshilla, siguruar informacion dhe lidhje midis shtëpisë dhe shkollës. HSCL gjithashtu mbështet prindërit duke i lidhur ata me shërbime të tjera si mbështetje të komunitetit dhe shërbime të tjera. Programi i përfundimit të shkollës (SCP) mbështet nxënësit që janë në rrezik të largimit të hershëm nga shkolla ose nxënësve që mund të kenë ndaluar së ndjekuri shkollën për arsye të ndryshme. Ju duhet të kontrolloni me mësuesin ose drejtorin e klasës së fëmijës suaj dhe ata mund t'ju tregojnë nëse shkolla ka në dispozicion njërën nga këto mbështetje dhe do t'ju ndihmojnë të kontaktoni me ta.

Nëse shkolla ka vendosur mbështetjen nga Shërbimi Kombëtar Arsimit Psikologjik ose për mbështetje të tjera të tilla si terapia e të folurit dhe e gjuhës për fëmijën tuaj, duhet të shihni me shkollën se çfarë mund të bëhet në lidhje me mbështetjen në këtë kohë.

### **Po sikur të shqetësohem për nivelin e kontaktit midis shkollës dhe mua dhe/ose fëmijës tim?**

Nëse mendoni se mësuesi i shkollës ose fëmija juaj nuk po mban kontakte me ju dhe/ose fëmijën tuaj, duhet që në radhë të parë të telefononi, shkruani ose t'i dërgoni email shkollës ose personit të kontaktit të shkollës. Personi i kontaktit mund të jetë mësuesi i klasës, mësuesi i arsimit special, koordinatori i HSCL ose drejtori i shkollës.

Nëse jeni të shqetësuar se nuk po merrni përgjigje nga shkolla, brenda disa ditësh, mund të ndiqni procedurat e ankesave të shkollës. Kjo përfshin referimin e shqetësimit tuaj drejtorit të shkollës dhe pastaj kryetarit të bordit të menaxhmentit kur është e nevojshme. Informacioni se si të bëni ankesë është në dispozicion në [Seksionin e prindërve](#) në faqen e internetit të Ministrisë. Në rastin e shkollave të Bordit arsimor dhe Trajnues (ETB), mund të kontaktoni Bordin vendor të arsimit dhe aftësisimit; detajet e kontaktit janë në dispozicion këtu [ETBI directory](#).

Sidoqoftë, nëse keni vështirësi të kontaktoni shkollën për t'ju qasur procedurave ankesore të shkollës gjatë kësaj mbyllje urgjente të shkollës, mund të kontaktoni Ministrinë në [schoolgovernance@education.gov.ie](mailto:schoolgovernance@education.gov.ie).

### **Si mund ta mbështes fëmijën tim?**

Nga ju nuk pritet të jeni mësuesi i fëmijës tuaj gjatë kësaj kohe. Mësuesit do të vazhdojnë të punojnë me të gjithë nxënësit e tyre, por ka gjëra praktike që ju mund të bëni si prind për të mbështetur fëmijën tuaj ndërsa mëson nga shtëpia.

#### **Vendosni një rutinë**

Kjo përfshin të kujdeseni që fëmija juaj ngrihet dhe shkon në shtrat në kohën e zakonshme, dhënien e vakteve, kohën e lojërave dhe kohën e lirë, aktivitetet familjare, punët e shtëpisë, ushtrimet dhe detyrat e shkollës.

*Është e dobishme që të hartoni rutinën me fëmijën tuaj në mënyrë që ata të ndjehen se kanë pasur zgjedhje në mënyrën se si shkon dita e tyre. Ata kanë më shumë mundësi t'i përmbahen një rutine që ata kanë ndihmuar ta zhvillojnë.*

*Kur vendosni rutinën e përditshme, duhet të merrni parasysh disponueshmërinë dhe përdorimin e pajisjeve nga të tjerët në shtëpi. Ju mund të gjeni këshillat në [faqen e internetit të Shërbimit Kombëtar Arsimit Psikologjik \(NEPS\)](#) të dobishme për krijimin e rutinave të reja për fëmijën tuaj.*

*Programet televizive të zhvilluara posaçërisht për fëmijët në Irlandë gjatë kësaj kohe mund të ndihmojnë kur zhvillonin një rutinë ditore të mësimin që është përfshirëse për fëmijën tuaj.*

**Home School Hub**  
RTÉ2: 11.00am-12.00pm  
E hënë – e premte

Kliko linkun poshtë



**Cúla 4 ar scoil**  
TG4: 10:00am-10:30am  
E hënë – e premte

Kliko linkun poshtë:



**Bëhuni gati për të mësuar**

*Mund të jetë e dobishme për rutinën e të mësuarit të fëmijës tuaj nëse mund t'i ndihmoni ata të gjejnë një vend ku mund të punojnë larg nga shpërqendrimet sa më shumë që të jetë e mundur. Fëmija juaj gjithashtu duhet të jetë i gatshëm për çdo orë mësimi ose aktivitete të planifikuara me mësuesit e tyre nëse shkolla po përdor këtë formë të komunikimit dhe ju/fëmija juaj keni pajisjet dhe teknologjinë e duhur në dispozicion.*

**Bisedoni me fëmijën tuaj dhe vlerësoni përpjekjet e tyre**

*Biseda me fëmijën tuaj për punën që duhet të bëjë, afatet për kthimin e punës së përfunduar të mësuesit dhe orari i ndonjë mësimi në internet mund t'i ndihmojë ata të qëndrojnë të përqendruar dhe në rrugën e duhur. Do t'i tregojnë gjithashtu se ju vlerësoni punën që bëjnë. Falënderimet për përpjekjet e tyre janë gjithashtu të rëndësishme dhe do t'i ndihmojnë ata të qëndrojnë të motivuar dhe të ndiejnë një ndjenjë arritjeje pasi përfundojnë aktivitetet.*

**Kontrolloni komunikimet**

*Ju duhet të kontrolloni rregullisht metodat e komunikimit që shkolla ju ka thënë që ata do të përdorin për të qëndruar në kontakt në lidhje me mësimin e fëmijës tuaj. Nëse keni ndonjë vështirësi me metodat e komunikimit që përdoren, duhet ta njoftoni shkollën sa më shpejt që të mundeni, në mënyrë që të pajtoheni me një mënyrë për të mbajtur kontakte që funksionon më mirë si për shtëpinë ashtu edhe për shkollën.*

**Qëndroni pozitiv**

*Është shumë e rëndësishme të qëndroni pozitiv në këtë kohë dhe të mbani një qasje të ekuilibruar ndaj pamjeve të lajmeve ndaj të cilave fëmija juaj është i ekspozuar. Linku i mëposhtëm mund të jetë i dobishëm kur flisni me fëmijën tuaj për Covid-19: [Bisedoni me fëmijët dhe të rinjtë për Covid-19](#) Është e rëndësishme të shmangni tensionet në lidhje me punën në shkollë. Nëse lindin probleme, duhet të bisedoni me fëmijën tuaj në një kohë kur të dy jeni gati për të folur. Gjithashtu mund të kontaktoni mësuesin e klasës ose shkollën për këshilla.*

## Si mund ta mbështes një fëmijë që e ka të vështirë të bëjë punë shkollore në shtëpi?

Së pari, është e rëndësishme të dini se ju dhe fëmija juaj nuk jeni vetëm. Shumë fëmijë dhe prindër e kanë të vështirë të përshtaten për të punuar dhe mësuar nga shtëpia.

### Mësojeni pse

*Hapi i parë është të përpiqeni të zbuloni pse fëmija juaj e ka të vështirë të bëjë punë shkollore në shtëpi. Fëmija juaj mund ta ketë të vështirë të mësohet me rutinën e re të shkollës shtëpiake, të shqetësohet për situatën aktuale ose të ketë frikë për të ardhmen. Ndoshta janë të pasigurt për atë që pritet prej tyre në mësim, e kanë vështirësi të mësojnë ose me një fushë kurrikulare të veçantë, ose ndoshta kanë ndonjë problem mjekësor. Pritjet tuaja ose të mësuesit mund të jenë joreale.*

### Eksploroni çfarë po ndodhë

Gjeni një kohë të qetë për të eksploruar se çfarë po ndodh për fëmijën tuaj duke pirë çaj ose gjatë një shëtitje etj. Ndhmoni fëmijën tuaj të kuptojë se shumë nga ndjenjat, mendimet dhe sjelljet e tyre janë përgjigje normale ndaj situatës aktuale dhe më pas eksploroni mënyrat e menaxhimit ose adresimin e këtyre.

### Gjeni një rutinë të re

Ndoshta keni nevojë të rimendoni ose pajtoheni për një rutinë të re për të siguruar që është realiste dhe e arritshme dhe përfshin pushime të mjaftueshme dhe të hapura mirë dhe kohë për aktivitete të këndshme.

### Eksploroni interesimet

Kjo mund të ndihmojë për të inkurajuar fëmijën tuaj për të identifikuar dhe eksploruar interesat e tyre. Ndonjëherë një pushim nga rutina për të trajtuar një projekt së bashku mund të ndihmojë për të lehtësuar tensionin dhe ankthin dhe për të ndihmuar fëmijën tuaj për të rifokusohet.

### Ask for help

*Mos kini frikë të kërkonti ndihmë nga shkolla dhe mësuesit që i njohin mirë nxënësit e tyre. Ata e kuptojnë që të gjithë po e gjejnë situatën aktuale shumë sfiduese dhe do të jenë të lumtur të mbështesin ty dhe fëmijën tënd. Nëse ka çështje që ndikojnë në aftësinë e fëmijës tuaj për të përfunduar punën në shtëpi, ose nëse mendoni se nuk është e mundshme që fëmija juaj të kryejë sasinë e punës së caktuar, ju lutemi njoftoni shkollën.*

Ask for help

Kërkonte ndihmë

## Si mund ta ndihmoj fëmijën tim të mbetet i sigurt ndërsa mëson nga distanca?

Është e rëndësishme që fëmija juaj të qëndrojë i sigurt kur punon ose përdor materiale në internet ose nga distanca. Është gjithashtu e rëndësishme që fëmija juaj të veprojë me përgjegjësi ndërsa është i angazhuar në mësimin në internet. Shkolla dhe mësuesit tashmë do të ndërmarrin hapa, por janë edhe disa gjëra që ju mund t'i bëni për të ndihmuar. Këto përfshijnë:

- ta rikujtoni fëmijën tuaj të ndjekë rregullat e caktuara nga mësuesi për aktivitetin në internet
- të pajtoheni për aranzhimet për orët në internet me mësuesin e fëmijës tuaj
- të monitoroni aktivitetin në internet të fëmijës tuaj
- të instaloni shfletues të internetit të përshtatshëm për fëmijë dhe filtra të internetit me mbështetje nga shkolla
- të inkurajoni të qëndruarit korrekt për fëmijën tuaj gjatë punës në internet

Politika e Përdorimit të Pranueshëm i shkollës për përdorimin e internetit të nxënësve në internet në shkollë specifikon të drejtat, përgjegjësitë dhe sanksionet që lidhen me përdorimin e kompjuterit për punën në shkollë. Ju duhet ta lexoni këtë dokument dhe të siguroheni që t'i kuptoni kërkesat për sjellje të përshtatshme.

Këshilla të tjera për prindërit dhe fëmijët se si të punojnë në mënyrë të sigurt në internet janë në dispozicion në faqen e internetit [webwise.ie/parents/](https://www.webwise.ie/parents/) ose [Be Safe Online](#).

Punonjësit socialë të Tusla-s gjithashtu vazhdojnë të ofrojnë mbështetje familjare dhe shërbime të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve. Mund të gjeni informacione shtesë në faqen [Covid-19 page](#) dhe [Parenting 24 seven page](#) të faqes së internetit të Tusla-s.

## Çfarë mbështetje ka nëse fëmija im po shkon në shkollën pas-fillores në shtator?

Nëse fëmija juaj i klasës së gjashtë ka një vend të konfirmuar në një shkollë pas-fillore për Shtatorin 2020, duhet të bisedoni me drejtorin dhe mësuesin tuaj të klasës për lëvizjen e tyre në shkollën pas-fillore dhe çdo informacion që ju nevojitet nga shkolla për shkollën e re. Shkolla pas shkollës fillore gjithashtu mund të jetë në kontakt në lidhje me aranzhimet për nxënësit e vitit të parë.

Nëse fëmija juaj që është në klasën e 6-të nuk ka një vend të konfirmuar në një shkollë pas-fillores për Shtatorin 2020, duhet të bisedoni me drejtorin dhe mësuesin tuaj të klasës dhe të kërkonti ndihmën e tyre. Nëse është e nevojshme, drejtori juaj do t'ju sigurojë detajet e kontaktit për Zyrtarin e Mirëqenies Arsimore (ZMA). Përndryshe, ju mund të dërgoni me email [tessinfo@tusla.ie](mailto:tessinfo@tusla.ie) duke u siguruar që të lini detajet e kontaktit dhe emrin e shkollës që fëmija juaj aktualisht ndjek, dhe një ZMA do t'ju kontaktojë.



## Çfarë mbështetje të tjera ka për mua si prind apo kujdestar?

**Nga Ministria e Arsimit dhe Aftësive:** Ministria siguron informacione të azhuruara mbi krizën Covid-19 dhe mundësinë e përdorimit të burimeve të siguruara nga agjensi të ndryshme në faqen [Covid-19 page](#) të faqes së internetit të Ministrisë.

**Nga prindërit e tjerë:** Mbajtja e kontaktit me prindërit e tjerë për të biseduar dhe shkëmbyer përvojat do të jetë një mbështetje e vlefshme për ju në këtë kohë. Këshilli i Prindërve ose Shoqata e Prindërve në shkollë mund të jenë një burim i rëndësishëm informacioni dhe mënyra e mbajtjes së kontaktit me shkollën dhe prindërit e tjerë. Ju gjithashtu mund ta keni të dobishme të kontaktoni Këshillin Kombëtar të Prindërve (Filllore) përmes faqes së tyre të [internetit](#) ose faqes në [Facebook](#).

**Nga faqet e internetit të tjera:** Qendra e Prindërve në [gov.ie/parents](http://gov.ie/parents) ofron informacion dhe këshilla për prindërit dhe familjet e tyre në këtë kohë në një varg temash, përfshirë mësimin dhe përkrahjen e prindërve.

### Faqet e internetit me burime arsimore

- Faqja e internetit [Scoilnet](#) identifikon burimet për mësimin në distancë dhe siguron lidhje me shërbimet mbështetëse të Ministrisë së Arsimit dhe Aftësive.
- Shërbimet e Zhvillimit Profesional për Mësuesit ofrojnë mbështetje dhe burime për prindërit dhe fëmijët e tyre në linqet e mëposhtme:
  - [PDST- Irish Independent Articles](#) siguron artikuj për prindërit të shkruar nga PDST dhe të botuar çdo javë në Irish Independent
  - [PDST- Online Tools Tutorials](#) u jep mundësi mësimeve të shkurtra në lidhje me mjetet dixhitale që fëmija juaj mund të përdorë për t'u përfshirë në mësimin në distancë në shtëpi
  - [PDST- Digital Libraries](#) i jep mundësi përdorimit të një numri bibliotekash në internet për të mbështetur mësimin e shkollimit të fëmijës së tyre në shtëpi
  - [PDST- Sources of Information](#) jep mundësinë e përdorimit të Worldbook Online dhe burimeve të tjera të besueshme të informacionit që mund të përdoren në shtëpi kur studentët janë të angazhuar në punën e projektit.
- Ark siguron një gamë të plotë të burimeve për të mbështetur angazhimin e fëmijëve të shkollës fillore në arte në [ark.ie/](http://ark.ie/).

### Faqet e internetit që mbështesin mirëqenien

- [Shërbimi Kombëtar Arsimor Psikologjik \(NEPS\)](#) ofron këshilla dhe burime të vlefshme për shkollat dhe familjet për t'i mbajtur fëmijët dhe të rinjtë mirë gjatë Covid-19.

- Faqja e internetit [Fushata Jemi së bashku në këtë](#) jep shumë këshilla se si mund të kujdeseni për mirëqenien tuaj mendore, të qëndroni aktiv dhe të qëndroni të lidhur gjatë Covid-19. Jep këshilla për përbalimin e qëndrimit në shtëpi në këtë kohë.
- Shërbimi i Zhvillimit Profesional për Mësimdhënësit ofron një gamë të burimeve dhe aktiviteteve të mirëqenies për prindërit dhe fëmijët në linqet e mëposhtme:
  - [PDST - distance learning](#)
  - [PDST - relaxation and self-regulation tools](#)

#### *Faqet e internetit që mbështesin fëmijët me nevoja të veçanta arsimore*

- [Këshilli Kombëtar për Arsimim të Vecantë](#) ka burime të dobishme për prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në [ncse.ie/parent-resources](https://ncse.ie/parent-resources).
- [AsIAm's faqja e internetit](#) përmban shpjegime mbi situatën Covid-19 për fëmijë dhe të rinj me ASD përmes [përdorimit të tregimeve sociale](#). Gjithashtu ofron [burime për mësim në shtëpi](#).
- Qendra Middletown për Autizëm po jep këshilla përmes mediave sociale për të ndihmuar fëmijët dhe të rinjtë të menaxhojnë gjatë krizës Covid-19. Burimet për prindërit dhe fëmijët mund të gjenden në [middletownautism.com](https://middletownautism.com).